

VENDIM
Nr. 28, datë 27.8.2024

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, të kreut I, nenit 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, i ndryshuar, me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023 “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 28, datë 27.8.2024 si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega IV, Dosar i kuq, Dosje me informacione për thyesat e kufirit, me 2 volume, në total me 844 (tetëqind e dyzet e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1982–1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

2. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Vlorë, Dosje pune dhe personale nr. 1265, “Bleta”, në ngarkim të K. F., me 436 (katërqind e tridhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1972–1980. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

3. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, Dosje formulare nr. 3397, në ngarkim të Z. H., me 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1978–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

4. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega IV, Dosar i verdhë, Dosje me informacione për thyesat e kufirit, me 804 (tetëqind e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1982–1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

5. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega IV, Fashikull i thyesit të kufirit A. I., me 41 (dyzet e një) fletë. Dosja daton në vitin 1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

6. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega IV, Fashikull i thyesit të kufirit K. E., me 46 (dyzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

7. Arkivi i Autoritetit, Fondi Kosova, Dosja nr. 4475, në ngarkim të M. H., me 42 (dyzet e dy) fletë. Dosja daton në vitin 1945–1965. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

8. Arkivi i Autoritetit, Fondi të Arratisur, Dosje formulare nr. 480, në ngarkim të T. T., me 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1951–1965. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

- Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.

3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuar në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Gentiana Sula